

BASHKIA LEZHË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATOREVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

PËR:

OPERATORIN EKONOMIK “ALESIO-2014” SHPK, ME ADRESE NJËSIA BASHKIAKE NR.
11, RRUGA “LORD BAJRON”, BANESE PRIVATE NR. 14, TIRANE

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “ANTE-GROUP” SHPK& “FERRO BETON &
CONSTRUCTION CO” SHPK, PËRFAQËSUAR NGA OE “ANTE-GROUP” SHPK, ME
ADRESE LAGJIA “BARRIKADA”, ZONA KADASTRALE NR. 8501, GODINA ME NR.
PASURIE 3/423-ND, BERAT

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e Përsheptuar – Rindërtimi, e Kufizuar/Pune, “Marrëveshje
Kuaër”, me disa operatore ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-97324-06-03-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shembja e njesive individuale te banimit te pabanueshme, te
demtuara nga termeti i dates 26.11.2019 dhe transportimi i materialeve te dala nga shembja e tyre”.
Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuaër: 12 Muaj nga data e nënshkrimit te marrëveshjes Kuader.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

- 1- Operatori Ekonomik “ALESIO-2014” Shpk, me Nuis L41713003M,
- 2- Bashkimi i Operatorive Ekonomik “Ante-Group” Shpk, me Nuis J62904100D& “Ferro Beton &
Construction Co” Shpk, me Nuis K21505001Q,
- 3- Operatori Ekonomik “SIRETA 2 F” Shpk, me Nuis K51501008J,
- 4- Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” Shpk, me Nuis K12911201C,

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- Operatori Ekonomik “SIRETA 2 F” Shpk, me Nuis K51501008J,

- Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” Shpk, me Nuis K12911201C,

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1- Operatori Ekonomik “SIRETA 2 F” Shpk, me Nuis K51501008J, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

Se pari, OE nuk ka ngarkuar ne SPE sigurimin e ofertes sipas shtojces 5, te kërkuar ne Kriteret e Vecanta te kualifikimit parashikuar kjo ne piken 1/c. Ky kriter eshte shtuar ne procedurat ne kuader te procesit te rindertimit dhe eshte vendosur nga autoritet perkatese ne DST, te kriteret e vecanta (shtojcat), te cilat nuk mund te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Mospermbushja e ketyre kriterëve perben shkak per skualifikimin e ofertuesve.

Se dyti, duke marre ne konsiderate se ne kriteret e vecanta te kualifikimit percaktohet se: Kandidati/ofertuesi per te marre pjese ne procedurat e prokurimit duhet të dorëzojë ”Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1“, ku nder te tjeradeklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë që garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi si dhe lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi, KVO beri nje vlerësim objektiv i te gjithë dokumentacionit te marrëdhënies se punës te paraqitur ne SPE nga ky OE ne përmbushje te këtij kriteri ku vërehet se:

Disa nga kontratat individuale te punes te paraqitura, nuk jane te rregullta nga pikpamja formale ne formen e shkruar, pasi nuk ato nuk permbajne elementet minimal te nje kontrate individuale pune, te parashikuara nga neni 21 “Forma e Kontrates se Punes”, te Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, ku percaktohet se:

1. *Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.*
2. *Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës.*
3. *Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos: a) identitetin e palëve; b) vendin e punës; c) përshkrimin e përgjithshëm të punës; ç) datën e fillimit të punës; d) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; dh) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; e) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; ë) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; f) kohën normale javore të punës; g) referenca në kontratën kolektive në fuqi; gj) periudhën e provës; h) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive;*
4. *Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit.*

Sa argumentuam me lart, bazuar dhe ne piken 3, shkronja “a”, te Nenit 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: 3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës,

në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë; dokumentacioni i sipercituar nuk është ne perputhje me legjislacioni e Punes dhe si rrjedhojë ky kriter konsiderohet i pa permbushur nga ana e OE-se.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pikë 3/a dhe në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatori Ekonomik “SIRETA 2 F” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “SIRETA 2 F” Shpk, me Nuis K51501008J, skualifikohet.

2- Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” Shpk, me Nuis K12911201C, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

OE nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertes sipas shtojcës 5, të kërkuar në Kriteret e Vecanta të kualifikimit parashikuar kjo në pikën 1/c. Ky kriter është shtuar në procedurat në kuader të procesit të rindertimit dhe është vendosur nga autoriteti perkatese në DST, të kriteret e vecanta (shtojcat), të cilat nuk mund të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Mos përmbushja e këtyre kriterëve përben shkak për skualifikimin e ofertuesve.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pikë 3/a dhe në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të

garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” Shpk, me Nuis K12911201C, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

- 1- Operatori Ekonomik “ALESIO-2014” Shpk, me Nuis L41713003M,
- 2- Bashkimi i Operatorive Ekonomik “Ante-Group” Shpk, me Nuis J62904100D& “Ferro Beton & Construction Co” Shpk, me Nuis K21505001Q,

Shënim: Referuar VKM nr.225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkise Lezhe se bashku me dokumentacionin e noterizuar të ofertes tuaj, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14/06/2021

Ankesa: Nuk ka.